



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dated Received / Delivered	20. 11. 2020	viti / god Year	2020
Organ / Njesia Org / Jednost. Org / Unit	2020/ADM/113		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.336/2020

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.336/2020, të datës 28.10.2020, e parashtruar nga [redacted] me adresë Lagjja Arbëria Rr., Ahmet Krasniqi”, Nr. 208, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.11.2020, mori këtë;

**V E N D I M**

**HEDHET POSHTË** si e palejuar ankesa me numër A.nr.336/2020 e datës 28.10.2020, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

**A r s y e t i m**

Ankuesja [redacted], sipas akt emërimit të datës 08.06.2018, në pozitën “Drejtoreshë e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore”, në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datën 09.06.2020 ka parashtruar kërkesë me Nr.2020/ADM/147, pranë Komisionit Disiplinor në AACK për inicim të procedurës disiplinore kundër [redacted] në pozitën e punës “Udhëheqëse e njësisë së burimeve njerëzore”, me arsyetimin se e njëjta, ka nxjerrë vërtetim, i cili nuk ka qene fare i protokolluar, lidhur me përvojën e punës menaxheriale për [redacted] (ish Kryeshef Ekzekutiv) në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i AACK-së, me datën 13.07.2020 ka nxjerrë vendimin me numër Nr.2020/KD/175, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses, me arsyetimin se çështja në fjale nuk është në kompetencë të Komisionit Disiplinor, pasi që e njëjta është duke u hetuar nga organet kompetente.

E pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të AACK-se, me datën 06.08.2020 ka parashtruar ankesën me numër Nr.2020/ADM/196 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, mirëpo i njëjti nuk ka nxjerrë vendim lidhur me ankesën e ankueses.





Ankuesja, kundër heshtjes administrative nga Komisioni i Ankesave i AACK-se dhe kundër vendimit të datës 13.07.2020, me numër Nr.2020/KD/175 të Komisionit Disiplinor, me datën 28.10.2020 parashtron ankesë me numër protokollit 2309/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se: [REDAKTUAR] ne pozitën e Menaxheres së Personelit, kundërligjshëm ka falsifikuar përvojën menaxheriale për [REDAKTUAR] për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; kundër Vendimit me numër Nr.2020/ADM/147, të datës 13.07.2020 të Komisionit Disiplinor nga ACC dhe kundër heshtjes administrative nga Komisioni i Ankesave të ACC-se.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.11.2020, ka proceduar tek Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit për përgjigje në ankesë, ndërsa më datën 13.11.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura.

**Administrimi i provave-Kolegji** për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.336/2020, të datës 28.10.2020, me numër protokollit 2309/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.11.2020; Vendim i datës 12.05.2020 për shkarkimin nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm të ACC-se të [REDAKTUAR] me shkresat zyrtare drejtuar Qeverisë së Kosovës; Vërtetim i datës 06.10.2016 për përvojën menaxheriale të [REDAKTUAR]; Kontratë e punësimit e datës 12.07.2010 për [REDAKTUAR]; Kontrate e punësimit e datës 13.07.2011 për [REDAKTUAR] Akt emërimi i datës 31.07.2012 për [REDAKTUAR]; Shkresë zyrtare e datës 30.10.2018; Memorandum shpjegues për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ACC-se i datës 23.11.2018; E-mailat zyrtar të datës 05.07.2018; E-maili zyrtar i datës 04.07.2020; E-maili zyrtar i datës 08.07.2020; Kërkesë e datës 09.06.2020 për iniciimin e procedurës disiplinore; Vendim i datës 13.07.2020 i Komisionit disiplinor të ACC-se; Ankesë e datës 06.08.2020 drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të ACC-se; Akt emërimi i datës 08.06.2018 i [REDAKTUAR] Vendim i datës 04.11.2020; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit; E-maili zyrtar i datës 13.07.2013; E-maili zyrtar i datës 08.06.2020; E-maili zyrtar i datës 05.06.2020; E-maili zyrtar i datës 04.06.2020; E-maili zyrtar i datës 03.06.2020; Kërkesë për pushim e datës 30.07.2020; Shënim zyrtar i datës 08.01.2020; Njoftim i datës 30.07.2020 i Prokurorisë Themelore në Prishtinë; E-maili zyrtar i datës 23.07.2020; Aktvendim i datës AA.nr.957/2019 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Aktvendim i datës 01.11.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses [REDAKTUAR], është e pa lejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në Aktin e emërimit të datës 19.07.2019, përshkrimin e detyrave të punës të nëpunëses civile [REDAKTUAR], ka konstatuar se: [REDAKTUAR], është e emëruar në pozitën e punës "Udhëheqëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore", me afat të përhershëm dhe e njëjta i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave bazuar në shkresat e lëndës, ka gjetur se kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore ndaj [REDAKTUAR] nuk është dërguar paraprakisht për shqyrtim të Drejtorit të Përgjithshëm si udhëheqës i drejtpërdrejtë i saj, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 48 paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit NR. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020, për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik. Bazuar në këtë, Kolegji vlerëson se ankuesja [REDAKTUAR] meqenëse nuk është mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e [REDAKTUAR], e njëjta nuk ka mundur të iniciojë procedurë disiplinore drejtpërdrejtë në Komision Disiplinor.




Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se : në çështjen juridike kontestuese mungon legjitimiteti juridik i ankueses/palës, për faktin se edhe vendimi i Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, e refuzon kërkesën për ndërmarrjen e masave ndaj znj. ██████████ sepse thekson se : “çështja për momentin nuk është ne kompetence të Komisionit Disiplinor, duke marrë parasysh që rasti është duke u hetuar nga organet tjera kompetente”, andaj në kuptim të kësaj edhe kërkesa e ankueses e datës 09.06.2020 me Nr.2020/ADM/147, kundër ██████████ nuk ka prodhuar ndonjë pasojë juridike lidhur me të drejtat dhe interesat juridike të ankueses, respektivisht nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses që do të përbënte shkak të arsyeshëm ligjore që ankuesja të parashtronte ankesë kundër komisionit gjegjës, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 124 i cili përcakton se: *pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, ndërsa neni 129 i po të njëjtit Ligj përcakton: ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: ..... 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji.*

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesja ██████████ të hedhet poshtë si e pa lejuar.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr. 336/2020**

**Ardita Perçuku-Shyti**  
  
Procesmbajtëse

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**  
  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses ██████████;
- Drejtorit të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Arkivit të KPMSHCK-së